Në bazë të nenit 21, paragrafi (1), pika 11 të Statutit të Institucionit Nacional Xhaz, a në lidhje me nenin 77-g të Ligjit të Kulturës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 187/2013, 44/2014, 61/2015, 154/2015, 39/2016 dhe 11/2018), Këshilli Drejtues i Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup, më , miratoi:

-- Седница одржана на

НАЦИОНАЛНА УСТАНОВА
ОРКЕСТАР ЗА ЏЕЗ МУЗИКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
INSTITUTI NACIONAL
ORKESTRA E XHAZ MUZIKËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Бр.-Nr. 02-113
24.01.
со вработување за категориите А - 20 год.-viti

Rregullore

Për procedurën e plotësimit të vendit të punës me punësim për kategoritë: A – artistë, B – bashkëpunëtorë artistikë për përgatitjen e veprave skenike dhe muzikore, V – bashkëpunëtorë profesionalë skenikë dhe G – bashkëpunëtorë profesionalë në veprimtaritë nga fusha e kulturës; për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike dhe të aplikimit për punësim, mënyrën e zhvillimit të përzgjedhjes dhe intervistës, përkatësisht audicionit.

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet procedura për plotësimin e vendeve të punës përmes punësimit për kategoritë: A – artistë, B – bashkëpunëtorë artistikë për përgatitjen e veprave skenike dhe muzikore-skenike, V – bashkëpunëtorë profesionalë skenikë dhe G – bashkëpunëtorë profesionalë në veprimtaritë nga fusha e kulturës, si dhe forma dhe përmbajtja e shpalljes publike dhe e aplikimit për punësim, mënyra e zhvillimit të përzgjedhjes dhe intervistës, përkatësisht audicionit.

Neni 2

Për fillimin e procedurës për plotësimin e vendit të punës, drejtori i institucionit miraton vendim për nevojën e punësimit, i cili përmban numrin dhe datën e Planit vjetor të punësimit, mbi bazën e të cilit zhvillohet procedura e punësimit, si dhe emërtimin e vendeve të punës për të cilat do të zhvillohet procedura.

Shpallje publike

Neni 3

Shpallja publike për plotësimin e një vendi të punës përmban:

- stemën dhe emrin e republikës, si dhe logon dhe emërtimin e institucionit;
- bazën ligjore për publikimin e shpalljes publike;
- numrin e shpalljes publike;

- për çdo vend pune të ndryshëm në shpallje: numrin rendor, kodin, emërtimin dhe numrin e ekzekutuesve;
- për çdo vend pune të ndryshëm në shpallje: kushtet e përgjithshme (në pajtim me ligjin dhe Marrëveshjen kolektive), kushtet e veçanta (arsimimin, përvojën e punës, kompetencat e përgjithshme dhe të veçanta të punës, në pajtim me Aktin e Sistematizimit të Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup);
- për çdo vend pune të ndryshëm në shpallje: orarin e punës, fillimin dhe përfundimin e orarit ditor dhe javor të punës;
- mënyrën dhe vendin ku duhet të dorëzohet aplikimi dhe dëshmitë e detyrueshme për përmbushjen e kushteve për punësim;
- informacion të shkurtër për mënyrën e zhvillimit të procedurës (fazat: kontrollimi i aplikimit dhe dëshmive, si dhe intervista/audicioni).
-

Neni 4

(1) Shpallja publike për punësim publikohet në ueb-faqen e institucionit publik nga fusha e kulturës dhe në së paku tre gazeta ditore, prej të cilave njëra nga gazetat botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(2) Në shpalljen publike përcaktohet kategoria, niveli dhe kushtet për plotësimin e vendit të punës.

(3) Afati për aplikim në shpalljen publike nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dita e publikimit të saj në gazetat ditore.

Aplikim për punësim

Neni 5

Aplikimi për punësim në një vend pune përmban veçanërisht:

- të dhënat për kandidatin (emri dhe mbiemri, data dhe vendi i lindjes, adresa dhe vendbanimi, adresa elektronike e kandidatit, telefoni kontaktues, përkatësia në bashkësi);
- biografi e shkurtër;
- deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme për vendin e punës, duke shënuar PO/JO për secilin kusht veçmas;
- deklaratë për përmbushjen e kushtit shtesë nga shpallja, duke shënuar PO/JO për secilin kusht, nëse kërkohet.

Kandidatët mund të dorëzojnë edhe dëshmi për përsosje ose trajnime shtesë profesionale që lidhen me vendin e punës që plotësohet.

Komisioni i procedurës së punësimit

Neni 6

(1) Për zbatimin e procedurës së punësimit, drejtori i institucionit me aktvendim formon Komisionin për Procedurën e Punësimit.

(2) Komisioni për Procedurën e Punësimit përbëhet nga tre punonjës udhëheqës, përkatësisht: kryetari dhe dy anëtarë, si dhe zëvendësit e tyre. Kryetar i komisionit është personi udhëheqës i njësisë organizative në të cilën plotësohet vendi i punës, një anëtar është person udhëheqës nga njësia organizative për burime njerëzore dhe një anëtar tjetër nga një vend pune udhëheqës.

(3) Në rast se komisioni nuk mund të formohet në pajtim me paragrafin (2), komisionin e përbëjnë cilido punonjës me status ofrues të shërbimeve publike në fushën e kulturës – dy anëtarë dhe një anëtar nga njësia organizative për burime njerëzore.

Përzgjedhja e kandidatëve

(1) Procedura e përzgjedhjes për punësim përbëhet nga verifikimi i vërtetësisë së të dhënave të paraqitura në aplikimin për punësim, duke i krahasuar ato me dëshmitë e dorëzuara sipas shpalljes publike, me qëllim që të përcaktohet nëse kandidatët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në shpalljen publike.

Përzgjedhja e kandidatëve

Neni 7

(1) Procedura e përzgjedhjes për punësim përbëhet nga verifikimi i vërtetësisë së të dhënave të paraqitura në aplikimin për punësim, duke i krahasuar ato me dëshmitë e dorëzuara sipas shpalljes publike, me qëllim që të përcaktohet nëse kandidatët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në shpalljen publike.

(2) Pas përfundimit të përzgjedhjes së kandidatëve, komisioni harton procesverbal. Procesverbalit, për secilin vend pune të shpallur, i bashkëngjitet lista e kandidatëve me dokumentacion të parregullt dhe lista e kandidatëve me dokumentacion të rregullt, me këto të dhëna: emri dhe mbiemri i secilit kandidat me dokumentacion të parregullt dhe arsyeja e parregullsisë së tij; emri dhe mbiemri i kandidatëve me dokumentacion të rregullt; lista e kandidatëve që vazhdojnë në intervistë/në audicion.

(3) Kandidatët që e kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të vërtetësisë së dëshmive kanë të drejtë të vazhdojnë në intervistë, përkatësisht në audicion – për artistët.

Mënyra e realizimit të intervistës

Neni 8

(1) Intervista me kandidatët për punësim zhvillohet nga komisioni për procedurën e punësimit.

(2) Gjatë intervistës, nëpërmjet pyetjeve vlerësohen kompetencat e nevojshme për kategorinë dhe nivelin të cilit i përket vendi i punës.

(3) Për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës, kandidatët njoftohen në adresën elektronike dhe në numrin e telefonit të shënuar në fletëparaqitjen e tyre.

(4) Gjatë intervistës mund të parashtrohen pyetje në formë gojore, në formë të shkruar ose në kombinim të të dyja formave.

(5) Intervista përbëhet nga pyetje të përcaktuara në formularë të përgatitur paraprakisht, si vijon:

- pyetje të përgjithshme, nëpërmjet të cilave vlerësohen interesi dhe motivimi i kandidatit për vendin e punës, pyetje lidhur me përvojën e mëparshme të punës (nëse ka), pritshmëritë e kandidatit nga punësimi dhe të ngjashme; Pyetje sipas situatave, nëpërmjet të cilave vlerësohen kompetencat e përgjithshme të punës të nevojshme për kategorinë së cilës i përket vendi i punës;
- pyetje profesionale ose detyra praktike, nëpërmjet të cilave vlerësohen kompetencat e veçanta profesionale që lidhen me fushëveprimin e vendit të punës.

(6) Komisioni i vlerëson kandidatët duke plotësuar një formular për secilin kandidat, ku kandidati për secilin grup pyetjesh mund të marrë nga 5 deri në 10 pikë.

(7) Lista e renditjes së kandidatëve përcaktohet në bazë të numrit të përgjithshëm të pikëve. Në rast se dy ose më shumë kandidatë marrin numër të njëjtë pikësh nga komisioni, bëhet renditja e tyre sipas numrit të vlerësimeve më të larta që ka marrë secili kandidat.

(8) Për intervistën e zhvilluar, komisioni harton procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Procesverbali përmban këto të dhëna: datën, kohën dhe vendin e zhvillimit të intervistës; numrin e shpalljes; kandidatët e ftuar në intervistë; kandidatët që kanë marrë pjesë në intervistë; pikët e fituara; listën e renditjes së kandidatëve me numrin e përgjithshëm të pikëve; emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e anëtarëve të komisionit.

(9) Procesverbalin me listën e renditjes së kandidatëve, propozimin për kandidatin e përzgjedhur dhe vlerësimet përmbledhëse për secilin kandidat, komisioni ia dorëzon drejtorit brenda tre ditëve, me qëllim marrjen e vendimit për përzgjedhje. Bashkëngjitur me procesverbalin dorëzohen edhe formularët e vlerësimit nga intervista e zhvilluar.

Neni 9

Në bazë të procesverbalit të dorëzuar nga komisioni, brenda pesë ditëve nga marrja e propozimit, drejtori është i detyruar të marrë vendim për përzgjedhjen, i cili u dërgohet kandidatëve dhe publikohet në ueb-faqen dhe në tabelën e shpalljeve të institucionit.

Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Këshillit drejtues të Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup, brenda tetë ditëve nga dita e pranimit të vendimit për përzgjedhje.

Neni 10

Në afat prej pesë ditëve nga dita e përzgjedhjes së vendimit përfundimtar, drejtori merrë vendimin për punësimin dhe me kandidatin e përzgjedhur lidh kontratë pune, në pajtim me dispozitat ligjore.

Audicion

Neni 11

(1) Në audicion kontrollohen aftësitë artistike të kandidatit.

(2) Për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të audicionit, kandidatët njoftohen në mënyrë elektronike dhe në numrin e telefonit të shënuar në fletëparaqitje.

(3) Mënyra e zhvillimit të procedurës së audicionit dhe vlerësimi me pikë i kandidatëve përcaktohen me një akt të veçantë, në të cilin përcaktohen artistët që janë të detyruar t'i nënshtrohen audicionit.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 12

Dispozitat e kësaj rregulloreje, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me zhvillimin e audicionit, do të zbatohen edhe për zhvillimin e procedurës së punësimit për vendet e punës të cilat me Aktin e sistematizimit nuk janë përcaktuar si Shërbim artistik – Orkestra e Muzikës Xhaz.

Neni 13

Këtë rregullore e miraton Këshilli drejtues i Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar për miratimin e saj.

Neni 14

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj.

Rregullorja do të publikohet në tabelën e shpalljeve të institucionit.

IN "Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së" Shkup
Претседател на Управен одб
Сашко Николовски